

GUIDA E PRINDËRVE

KURRIKULA KOMBËTARE E ARSIMIT TË MESËM TË LARTË

Një guidë e thjeshtë për çdo prind.
Një pamje e përgjithshme e gjimnazit
të së ardhmes.

Gjimnazi

Plani i ri mësimor

► Siguron harmonizimin e nevojave bazë të arsimit në këtë nivel shkollor me interesat e nxënësve.

► Vendos një raport të ri ndërmjet kurrikulës bërthamë (lëndëve të detyrueshme) dhe kurrikulës me zgjedhje (lëndëve me zgjedhje):

- zvogëlon mundësinë e zgjedhjes në dy vitet e para të gjimnazit;
- shton numrin e orëve mësimore për zgjedhje në klasën e 12-të. (mbi 10 orë).

► Heq sistemin e koeficientëve për lëndët me zgjedhje.



► Zgjidh më mirë raportin ndërmjet kurrikulës bërthamë dhe kurrikulës së avancuar.

- Siguron mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit.
- Krijon mundësi për zgjedhje në grup të lëndëve (shoqërore ose shkencore).
- Siguron profilizim real dhe më të madh të nxënësve në shkollën e mesme.
- Zhvendos zgjedhjen e karrierës në një moshë më të pjekur.

- Shmang diskriminimin ndërmjet lëndëve.
- Shmang zgjedhjen fiktive.
- Ul ngarkesën për nxënësit që zgjedhin të profilizohen në një drejtim (shoqëror ose shkencor).

- Lehtëson ngarkesën e nxënësve në numër lëndësh dhe përmbajtje.
- Plotëson më mirë interesat e nxënësve të talentuar dhe me interes për t'u thelluar në fusha të ndryshme.
- Ofron mundësi reale për thellim në shkenca dhe në matematikë.
- Vendos balancë midis lëndëve shkencore dhe shoqërore.

Plani i ri mësimor

▶ Kurrikula e gjimnazit ofron module kurrikulare në përputhje me nevojat dhe mundësitë reale të çdo komuniteti.

▶ Modulet kurrikulare plotësojnë nevojën e nxënësve në drejtim të çështjeve prioritare të shoqërisë së shekullit XXI.

▶ Programet kurrikulare të gjimnazit krijojnë mundësinë që të shkruhen tekste shkollore më pak të ngarkuara e më të thjeshta për fëmijët tanë.

- Synon të aftësojë më shumë nxënësit për jetën.
- Mundëson angazhim më të madh të prindërve dhe pjesëtarëve të komunitetit.
- Aftëson nxënësit të përballen me çështjet aktuale të shoqërisë sot.

- Afrojnë shkollën tonë me standardet evropiane në fushën e teksteve mësimore.



Cilat janë fushat / lëndët e gjimnazit?

1. Gjuha shqipe dhe Letërsia

Lëndët "Gjuhë shqipe" dhe "Letërsi" janë pjesë e kurrikulës bërthamë dhe zhvillohen si lëndë më vete përgjatë tri viteve të gjimnazit. Kjo do t'u mundësojë nxënësve njohuri më të qëndrueshme rreth sistemit gjuhësor të gjuhës shqipe dhe studim më të thelluar të letërsisë shqipe dhe asaj botërore.

Lënda e letërsisë mundësohet edhe si program i avancuar në klasën e 12-të.

2. Gjuha e huaj

Gjuha e huaj e parë dhe gjuha e huaj e dytë (kur zgjidhet) zhvillohet gjatë të tri viteve të gjimnazit. Programi i gjuhës së huaj është hartuar në përputhje me nivelet e përcaktuara në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.

3. Matematika

Matematika është pjesë e kurrikulës bërthamë që zhvillohet gjatë tri viteve të gjimnazit. Ajo ofrohet edhe si matematikë e avancuar në klasën e 12-të, për nxënësit që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në fushën e shkencave të natyrës, të inxhinierive etj., të cilat kërkojnë njohuri dhe aftësi të thelluara matematikore.



Cilat janë fushat / lëndët e gjimnazit?

Matematika është më e lehtësuar në njohuri dhe aftësi, të cilat shihen të lidhura me përdorimin e tyre në fusha të tjera dhe në situata të jetës reale.

4. Shkencat e natyrës

Shkencat e natyrës (Fizika, Biologjia, Kimia) janë pjesë e kurrikulës bërthamë dhe zhvillohen gjatë tri viteve të gjimnazit. Ato ofrohen edhe në programe të avancuara në klasën e 12-të, për nxënësit që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në fushën e shkencave të natyrës, të inxhinierive etj., të cilat kërkojnë njohuri dhe aftësi të thelluara në këtë fushë.

5. Shkencat shoqërore

Shkencat shoqërore (Qytetaria, Historia, Gjeografia, Filozofia, Ekonomia, Sociologjia, Psikologjia etj.) zhvillohen si kurrikul bërthamë në klasën e 10-të dhe 11-të (Qytetaria, Historia, Gjeografia dhe Filozofia) dhe si lëndë me zgjedhje në klasën e 12-të (Ekonomia, Sociologjia, Psikologjia).

Këto lëndë vënë theksin në zhvillimin e aftësive të të rinjve për të marrë përgjegjësi për jetën e tyre, si dhe për të marrë pjesë si qytetarë aktivë dhe kompetentë në zhvillimet shoqërore.



Cilat janë fushat / lëndët e gjimnazit?

6.

Teknologjia dhe TIK-u



Teknologjia dhe TIK-u, gjithnjë e më shumë, janë duke u përdorur në shoqëri dhe ekonomi. Ato janë rruga e transformimit të mënyrës së punës, studimit, komunikimit, marrjes së informacionit dhe një mundësi për të kaluar në mënyrë produktive kohën e lirë. TIK-u zhvillohet si pjesë e lëndëve bërthamë në klasën e 10-të dhe 11-të dhe si lëndë me zgjedhje në klasën e 12-të. Në përmbajtjen e këtij programi përfshihen fitimi i aftësive praktike që do t'u shërbejnë nxënësve përgjatë gjithë jetës, si krijimi i faqeve web-i, dizenjimi, krijimi i animacioneve, paraqitja e transmetimeve në ndihmë të shkollës dhe të komunitetit për të zgjidhur probleme të jetës së përditshme etj. Vëmendje i kushtohet mësimit digjital, sigurisë kibernetike dhe krijimit të burimeve digjitale.

7.

Edukimi fizik, sportet dhe shëndeti

Edukim fizik, sporte dhe shëndet zhvillohet si pjesë integrale e procesit arsimor me 3 orë në javë. Programi i edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit ka në themel nevojat reale të nxënësve për informim dhe edukim, jo vetëm në aspektin e edukimit fizik e sportiv, por edhe në aspektin e edukimit shëndetësor. Si i tillë, edukimi fizik, sportet dhe shëndeti vlerësohet si një mjet për nxitjen dhe zhvillimin e aktivitetit të rregullt fizik dhe e një stili jetese aktive.

8. Artet

Artet janë pjesë integrale e jetës sonë të përditshme, ku gjejmë të mishëruara aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, në të cilën ndërveprojnë kultura dhe shoqëria.

Në këtë konceptim, artet zhvillohen në kurrikulën me zgjedhje, përmes tri lëndëve: Art pamor, Muzikë dhe Teatër. Ato unifikohen nëpërmjet emërimit, tematikave dhe kompetencave për të gjitha lëndët branda fushës së arteve.



